

BASHKIA TIRANE
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Agi Kons”shpk

Adresa: Kodra e Diellit II, Godinë e kombinuar 4 kat + 1 kat nëntokë, Selitë, Farkë, Tiranë

Procedura e prokurimit: “Procedure e Hapur” “Rehabilitimi i Parkut Rinia”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: ”Rehabilitimi i Parkut Rinia”.

Numri i references se procedures/lotit: REF-19931-04-26-2019

Fondi limit: 104,629,747 (njëqind e katër milion e gjashtëqind e njëzetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzetë e shtatë) lekë pa TVSH

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 159 datë 21.12.2018, “Për Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2019-2021”

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 03.06.2019, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **Nr. 18 datë 06.05.2019**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

çmimi më i ulët ☒ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “B 93” shpk NUIS J62903508R

Vlera e ofertës = 67,060,715 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa tvsh.

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Agi Kons” shpk NUIS K21622001M

Vlera e ofertës = 78,705,776 (shtatëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e pesëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Zdravo” shpk NUIS J84003411K

Vlera e ofertës = 81,740,978 (tetëdhjetë milion e shtatëqind e dyzetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kacdedja” shpk NUIS K51712017A

Vlera e ofertës = 83,668,761 (tetëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

**4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Shamo Konstruksion” shpk
NUIS L01326020F**

Vlera e ofertës = 85,205,205.90 (tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e pesëmijë e dyqind e pesë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk K71820009I

Vlera e ofertës = 86,840,148.89 (tetëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e dyzetë mijë e njëqinde dyzetë e nëntë pikë tetëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.

6. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Senka” shpk J94808405Q

Vlera e ofertës = 86,881,523 (tetëdhjetë e gjashtë milion e tetë qind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzetë e tre) lekë pa TVSH.

7. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kupa” shpk K51615512C

Vlera e ofertës = 96,898,610 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Operatori ekonomik “B 93” shpk.

- Operatori ekonomik “B-93” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial....”* pasi nga nga 2 (dy) punonjës hidraulik (Kategoria II) është paraqitur dokumentacion vetëm për 1-kategoria I.
- Operatori ekonomik “B-93” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial....”* pasi nuk është paraqitur dokumentacion për 2 (dy) punonjës pllakashtrues (Kategoria I).
- Operatori ekonomik “B-93” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 3 (tre) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari, te lëshuar nga institucione te autorizuar dhe te figurojne ne listëpagesat e shoqërisë”* pasi nuk është paraqitur dokumentacion për 3 (tre) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari.
- Operatori ekonomik “B-93” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi asnjë nga kamionët e paraqitur nuk plotëson kapacitetin 10-15 ton, kamioni me targë AA674LM=15,4 ton, kamioni me targë AA601NP=9,9 ton dhe kamioni me targë AA365PB=25,6 ton ndërsa për kamionin me targë AA913DE nuk është paraqitur polica e sigurimit.
- Operatori ekonomik “B-93” shpk nuk plotëson gjerman “a” të pikës 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Për mjetet në pronësi dhe me qera të targuara duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme). Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme). Mjetet duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi”* pasi për mjetin Autovinc me targë FR8664C nuk është paraqitur Çertifikata për Transport mallrash brenda vëndit.
- Operatori ekonomik “B-93” shpk nuk plotëson gjerman “c” të pikës 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”* pasi për mjetin eskavator me goma me targë AHMT 93 nuk është paraqitur foto.

2. Operatori ekonomik “Zdravo” shpk.

- Operatori ekonomik “Zdravo” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me*

- dokumentacionin e mëposhtme: **Librezë pune, Kontratë pune e vlefshme Diplomë**”, pasi për drejtuesin teknik të deklaruar, Arif Bajaziti nuk është paraqitur Librezë Pune.
- Operatori ekonomik “Zdravo” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, te perfshire ne licensen e shoqërisë ose pajisur me license individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (qjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:1 (një) inxhinier Ndërtimi, 1 (një) inxhinier Elektrik,1 (një) inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik,1 (një) inxhinier Hidroteknik,1 (një) inxhinier Mjedisi pasi rezulton si më poshtë vijon:
 - Operatori ekonomik “Zdravo” shpk ka deklaruar dy inxhinierë elektrikë përkatësisht me initiale A.D dhe A.A për të cilët nuk ka paraqitur Librezë Pune.
 - Operatori ekonomik “Zdravo” shpk ka deklaruar dy inxhinierë mjedisi përkatësisht me initiale A.N dhe A.H për të cilët Libreza e Punës është paraqitur fotokopje e pashoqëruar me Aktin e Noterizimit, çka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST, ku citohet se :” **Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim**”.
 - Operatori ekonomik “Zdravo” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë: 2 (dy) punonjës hidraulik (Kategoria II),2 (dy) punonjës elektrikist (Kategoria II),2 (dy) punonjës pllakashtrues (Kategoria I), pasi rezulton si më poshtë vijon:
 - Operatori ekonomik “Zdravo” shpk ka deklaruar dy punonjës hidraulikë përkatësisht me initiale E.C dhe N.K, për të cilët nuk është paraqitur diplomë, çka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST, ku citohet se :” Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diplomë përkatëse, dëshmite e kualifikimit te sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”.
 - Operatori ekonomik “Zdravo” shpk ka deklaruar dy punonjës elektrikistë përkatësisht me initiale F.Z dhe I.H, ku për punonjësin me initiale F.Z nuk është paraqitur diplomë, çka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST, ku citohet se :” Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diplomë përkatëse, dëshmite e kualifikimit te sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”.
 - Operatori ekonomik “Zdravo” shpk ka deklaruar dy punonjës pllakashtrues përkatësisht me initiale H.D dhe L.B për të cilët nuk është paraqitur diplomë, çka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST, ku citohet se :” Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diplomë përkatëse, dëshmite e kualifikimit te sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”.
 - Operatori ekonomik “Zdravo” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se:” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 3 (tre) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari, te

leshuar nga institucione te autorizuar dhe te figurojne ne listëpagesat e shoqërisë, pasi nuk ka deklaruar asnjë punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari.

- Operatori ekonomik “Zdravo” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi rezulton si më poshtë vijon:
- Operatori ekonomik “Zdravo” shpk ka deklaruar 2 kamionë me kapacitet mbajtës 5 ton-10 ton përkatësisht me targa AA165XF dhe AA5387FT. Mjeti me targë AA165XF ka tonazh prej 17.3 ton duke tejkaluar kapacitetin e kërkuar si dhe për të nuk është paraqitur çertifikatë pronësie. Mjeti me targë AA5387FT ka tonazh prej 25 ton duke tejkaluar kapacitetin e kërkuar.
- Operatori ekonomik “Zdravo” shpk ka deklaruar 2 kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 ton-5 ton përkatësisht me targa AA971PT dhe AA924DA. Mjeti me targë AA971PT ka tonazh prej 2.3 ton që rezulton nën tonazhin e kërkuar dhe për të nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash brenda vendit. Mjeti me targë AA924DA ka tonazh prej 1.1 ton që rezulton nën tonazhin e kërkuar dhe për të nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash brenda vendit.
- Operatori ekonomik “Zdravo” shpk nuk ka deklaruar në shtojcën 10 mjetin gazogjen.
- Operatori ekonomik “Zdravo” shpk nuk ka deklaruar në shtojcën 10 mjetin elektrosaldatrice.
- Operatori ekonomik “Zdravo” shpk nuk ka deklaruar në shtojcën 10 mjetin tokmak elektrik.

3. Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk

- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial...”* pasi për 2 punonjësit hidraulik dëshmitë e sigurimit teknik të rinovuara rezultojnë në kategorinë I dhe jo Kategoria II e kërkuar.
- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 3 (tre) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari, te lëshuar nga institucione te autorizuar dhe te figurojne ne listëpagesat e shoqërisë”* pasi për 3 punonjësit kopshtaë është paraqitur dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik për punonjësit që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike dhe jo dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari, te lëshuar nga institucione te autorizuar.
- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi asnjë nga kamionët nuk plotëson kapacitetin e kërkuar 10-15 ton, kamioni me targë AA521JF me kapacitet 7, 3 ton dhe kamioni me targë TR6607R me kapacitet 8,8 ton.

4. Operatori ekonomik “Shamo Konstruksion” shpk.

- Operatori ekonomik “Shamo Konstruksion ” shpk Operatori ekonomik nuk plotëson piken 5 tek kriteret e vecanta : *“Operatoret ekonomik duhet te kene te punesuar staf teknik*

per kryerjen e te gjithave punimeve te vertetuar me kontrate pune te vlefshme....” pasi për Inxhinierin elektrik nuk është paraqitur librezë e punes.

- Operatori ekonomik “Shamo Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 3 (tre) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari, të lëshuar nga institucione të autorizuar dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë”* pasi për punonjësit kopshtar nuk është paraqitur dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari.

5. Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk

- Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve si më poshtë: 2 (dy) punonjës hidraulik (Kategoria II), 2 (dy) punonjës elektrikist (Kategoria II), 2 (dy) punonjës pllakashtrues (Kategoria I),* pasi për punonjësit e kërkuar rezultoi se janë deklaruar dy punonjës hidraulikë, ku për punonjësin me initiale E.M është paraqitur vetëm një dëshmi kualifikimi, çka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST, ku citohet se: *“Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diplomë përkatëse, dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”*.
- Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk ka deklaruar katër punonjës pllakashtrues, përkatësisht me initiale Ç.K, H.S, E.L, P.S. Për punonjësin me initiale Ç.K nuk është paraqitur dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik. Për punonjësit me initiale E.L dhe P.S nuk është paraqitur diploma përkatëse, çka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST, ku citohet se: *“Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diplomë përkatëse, dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik (të vlefshme), si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”*.
- Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10), për mjetin autovinç , pasi për mjetin autovinç me targë GR1705B polica e sigurimit është e pavlefshme, pasi afati i vlefshmërisë ka përfunduar me datë 19.05.2019.*
- Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:*
 - *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 52,314,873 (pesëdhjetë e dy milion e treqind e katërmëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.*
 - *Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 209,259,494 (dyqind e nëntë milion dyqind*

e pesëdhjetë nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, pasi rezulton si më poshtë:

Operatori ekonomik "Leon Konstruksion" shpk ka deklaruar tetë objekte si punë të ngjashme:

1. Rikonstruksion i Bashkisë së Re, Berat.
2. Rikonstruksion i Qendrës së Integruar të Shërbimeve Publike, Gjirokastrë.
3. Rikualifikim i Bllokut të Banesave dhe Fasadave përgjatë rrugë hyrëse.
4. Rikonstruksion i Qendrës së Shërbimeve Publike të Integruara, Fier.
5. Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Qybra Sokoli.
6. Sinjalistikë e Infrastrukturës Turistike midis zonave bregdetare dhe malore.
7. Ndërtimi i Kopshtit Dyshnik dhe sistemimi i oborrit të shkollës në Vetterik, Berat.
8. Ndërtim i rrugës Ymer Beheluli.

Nisur nga objektet e deklaruar vetëm dy prej tyre përfshihen në kategorinë e punëve të ngjashme të infrastrukturës rrugore përkatësisht objektet: "Ndërtim i rrugës Ymer Beheluli" dhe "Sinjalistikë e Infrastrukturës Turistike midis zonave bregdetare dhe malore" përkatësisht me vlerë kontrate pa TVSH 38,861,256.5 dhe 7,496,055, të cilat nuk përmbushin vlerën e kërkuar në DST.

6. Operatori ekonomik "Senka" shpk

- Operatori ekonomik "Senka" shpk nuk plotëson pikën 1 të kriterëve të përgjithshme të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8*" pasi kjo deklaratë nuk është paraqitur sipas formatit të përcaktuar në DST.
- Operatori ekonomik "Senka" shpk nuk plotëson gjurmën "f" të pikës 15 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi)*" pasi Nuk është paraqitur Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe **vendndodhja e mjeteve** në pronësi ose me qera me qellim verifikimi.
- Operatori ekonomik "Senka" shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*" pasi Shtojca 10 është paraqitur për një objekt tjetër dhe jo për objektin konkret të prokurimit.
- Operatori ekonomik "Senka" shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial....*" pasi nga 2 punonjës hidraulikë kategoria II për njërin nuk është paraqitur dëshmia e sigurimit teknik.
- Operatori ekonomik "Senka" shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial....*" pasi nga 2 punonjës elektrik të kërkuar, është paraqitur kontratë pune vetëm për 1.

- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 3 (tre) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari, te leshuar nga institucione te autorizuar dhe te figurojne ne listëpagesat e shoqërisë”* pasi nuk janë paraqitur kopshtar me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari, te leshuar nga institucione te autorizuar.

7. Operatori ekonomik “Kupa” shpk

- Operatori ekonomik “Kupa” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi ne shtojcen dhjetë është deklaruar vetëm një kamion me kapacitet mbajtës 5-10 ton nga dy të kërkuar.
- Operatori ekonomik “Kupa” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 3 (tre) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari, te leshuar nga institucione te autorizuar dhe te figurojne ne listëpagesat e shoqërisë”* pasi nuk është paraqitur dokumentacion për kopshtar me dëshmi kualifikimi profesional për kopshtari, te leshuar nga institucione te autorizuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Agi Kons” shpk**, me adresë **Kodra e Diellit II, Godinë e kombinuar 4 kat + 1 kat nëntokë, Selitë, Farkë, Tiranë**, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **78,705,776** (shtatëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e pesë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 11.06.2019

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.